

VENDIM
Nr. 869, datë 30.9.2013

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 718, DATË 28.8.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR LEJIMIN E PUNËSIMIT, PAS LIRIMIT
NGA DETYRA TË NJË ANËTARI TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ENTIT
RREGULLATOR TË ENERGJISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shfuqizimin e vendimit nr. 718, datë 28.8.2013 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e miratimit paraprak për lejimin e punësimit, pas lirimit nga detyra, të një anëtari të bordit të komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama